



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1454/prot.
1

Tiranë më 4.102018

VENDIM

Nr. 48, datë 4.10.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra "Birn Albania", përfaqësuar nga Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1454 Prot., datë 01.10.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës së datës 14.09.2018 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni si më poshtë:

1. *Kopjen e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1959, datë 04.05.2018, për kërkesën e bërë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 03.11.2016, për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.*

Me shkresën nr. 14073/1 Prot., datë 25.09.2018 Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke i vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar në formë të anonimizuar, duke argumentuar se: *dokumentacioni i kërkuar ka për objekt akte procedurale, të cilat rregullohen nga ligji nr. 89/2017 "Kodi i Procedurës Penale", më konkretisht në nenin 103 të tij është parashikuar se: Ndalohe publikimi, qoftë dhe i pjesshëm i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre ndërmjet shtypit ose informacionit masiv. Në kushtet kur nuk provohet asnjë interes legjitim për të marrë këto*

akte, si dhe në rrethanat kur në brendinë e akteve ka të dhëna me karakter personal, refuzohet kërkesa”.

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik, ankuesi pretendon se: *Dokumentacioni i kërkuar përbën një çështje me interes publik duke qenë se lidhet me një kontratë partneriteti publik privat.*

Në këto kushte ankuesi kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili përcakton se: *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik, lidhur me refuzimin e dhënies së informacionit nuk qëndron, pasi emrat e kompanive të hetuara në vendimin e dhënë, nuk konsiderohen të dhëna personale. Këto të dhëna publikohen sipas legjislacionit shqiptar në QKB. Theksojmë se, anonimizimi i kompanive të hetuara të cituara në vendimin e pushimit duhet të mbështetet në rekomandimin nr. 8, datë 5.6.2013, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, i nxjerrë pas verifikimit të zbatimit të udhëzimit nr.15, datë 23.12.2011, “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, Udhëzimi Nr. 4059/2, datë 7.6.2016 “Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave”, pika 2, germa c) përcakton se procesit të anonimizimit i nënshtrohen të dhënat personale që lidhen me *gjeneralitetet e palëve/aksionarëve, përqindjeve të aksioneve/kuotave që zotërojnë palët, numrave të llogarive bankare, shumat monetare dhe sekretet tregtare*, pra emrat e kompanive nuk i nënshtrohen procesit të anonimizimit.

Gjithashtu, nga administrimi i provave të paraqitura nga ankuesi konstatohet se rezulton të ketë një vendim pushimi, pra dokumenti administrohet nga Autoriteti Publik.

Rrjedhimisht, në shqyrtimin e çështjes gjejnë zbatim dhe dispozitat e Ligjit nr. 7905 datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, së bashku me kufizimet që ky ligj mund të përmbajë lidhur me publikimin e informacionit.

Komisioneri vlerëson se kufizimet e pasqyruara nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar. Si rrjedhojë, dhënia e këtij informacioni nuk shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, ashtu si edhe në barazinë e palëve në proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, kufizime këto, të parashikuara në germat b) dhe dh) të nenit 17, të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Për të dhëna të tjera apo që lidhen me persona të tretë, Autoriteti Publik duhet të zbatojë kufizimet e përcaktuara në germën a) të pikës 1 të nenit 17, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të

drejtën e informimit” si dhe nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar duke kryer anonimizimin e të dhënave personale.

Në vijim të këtij arsytimi, vlen të theksohet gjithashtu se në pikën 6 të nenit 17, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përcaktohet se: “nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”. Në rastin konkret, rezulton se Autoriteti Publik ka anonimizuar vendimin në tejkallim të kufizimeve të përcaktuara në ligj. Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar është informacion publik, dhe duhet të procedohet me dhënien e tij duke respektuar referencat ligjore të cituara më sipër. E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në lidhje me ankimin e Z. kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mos marrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Z. , nr. 1454 datë 01.10.2018 ndaj autoritetit publik Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e autoritetit publik Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar lidhur me: *Kopjen e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1959, datë 04.05.2018, për kërkesën e bërë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 03.11.2016, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, brenda datës 11.10.2018.*
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 4.10.2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

